




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në mbështetje të Statutit të Komunës së Skenderajt si dhe nenit 9, pika 1/4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 të MPB-së dhe Nr. 03/2012 të MAPL-së, për KKSBB-së dhe nenit 7.3 të ligjit Nr. 04/L-76 për Policinë; Kryetari i Komunës

THËRRET

Mbledhjen e tretë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) për vitin 2026, e cila do të mbahet më **26/06/2026, ditë e premte**, duke filluar nga ora **13:30**, në sallën e Bordit të Drejtorëve në ndërtesën e komunës.

Për këtë mbledhje propozon këtë :

REND DITE

1. Vlerësimi i situatës së sigurisë para sezonit veror;
2. Diskutim mbi parandalimin e zjarreve gjatë sezonit të verës;
3. Diskutim rreth përgatitjes për pritje të bashkatdhetarëve;
4. Siguria në komunikacion dhe masat për parandalimin e aksidenteve;
5. Diskutim rreth mbarëvajtjes të sezonës së korrje-shirjeve;
6. Ruajtja e rendit dhe qetësisë publike;
7. Diskutim rreth çështjeve të sigurisë;
8. Parandalimi i dhunës në familje;
9. Të ndryshme.


Kryetari i Komunës
Sami Lushtaku





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr.
No. 02-052/01-0020219/26
Data
Data 02 06 2026



Republika e Kosovës

Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Ekstrakt nga proceverbali i mbledhjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Datë: 28.05.2026

Vendi: Salla e Bordit të Drejtorëve, në ndërtesën e Komunës

Të pranishëm në këtë mbledhje:

Nënkryetari i Komunës Fadil Nura dhe anëtarët e KKSBB-së: Agim Idrizaj (Policia e Kosovës), Kastriot Duraku (DKA), Sokol Hoxha(DShP), Avdi Jakupi(Përfaqësues i prindërve), Fatmir Balaj(ZKK), Arsim Haziraj (OJQ-Handikos), Qefsere Dautaj-Uka(ZBGJ), Valon Haliti (DI).

Në këtë mbledhje u diskutuan këto pika:

1. Hapja e mbledhjes dhe miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i situatës së sigurisë gjatë muajve të fundit;
4. Diskutim mbi sigurinë në shkolla dhe rreth tyre;
5. Parandalim i dhunës në familje;
6. Siguria në komunikacion;
7. Të ndryshme.

Nënkryetari i Komunës, Mirë se keni ardhë të gjithë, faleminderit shumë për prezencën, fillojmë me takimin e radhës të KKSBB-së, shkojmë sipas rendit të ditës: **Hapja e mbledhjes dhe miratimi i rendit të ditës,** a jeni të gjithë që të procedojmë me këtë rend të ditës? Kundër nuk ka, abstenim jo, atëherë konstatoj që është aprovu rendi i ditës. Pika e dytë: **Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,** a ka dikush ndonjë vërejtje në procesverbal, që eventualisht nuk është përfshirë ose është devijuar nga ajo që është diskutuar në takimin e kaluar? Nëse jo atëherë, konstatoj që procesverbali është në rregull. Vazhdojmë me pikën e tretë: **Shqyrtimi i sigurisë gjatë muajve të fundit,** komandant e ki fjalën.

Agim Idrizaj, fjala përshëndetëse, sa i përket situatës së sigurisë, me vete kam sjellur një raport, gjatë këtij pesë mujori i kemi 183 raste në përgjithësi, një pjesë e tyre penale, incidente të ndryshme dhe kundërvajtje, të gjitha rastet janë trajtu me efikasitet, sa i përket sigurisë, të ne situata është e qetë, vetëm një rast tentim-vrajse edhe për atë janë marrur të gjitha veprimet e nevojshme, i dyshuari tashmë është në paraburgim, organet e gjyqësisë janë duke u marrë me të.

Në takimin e kaluar, janë cek disa pika nga anëtarët e Këshillit, si shqetësim ka qenë vozitja nga personat nën moshën 18 vjeçare, afër shkollave. E kam nxjerrur një statistikë rreth kësaj dhe masat që janë ndërmarrë ndaj kësaj dukurie pas atij takimi. Gjithsej pa patent shofër janë identifikuar 37 raste dhe janë shqiptuar tiketa për kundërvajtje. 37 janë në Skenderaj, po ashtu 1 në Llaushë, në Polac 1, në Likoc janë 2, në Prekaz të Epërm 1 dhe në Turiqec 1 tiket, gjithsej janë 43 tiketa ndaj të miturve, nga data 01.01.2026-27.05.2026.

Për periudhën e ardhshme edhe me nivelin rajonal jemi dakordu që të kemi një takim të përbashkët me Shërbimin e Emergjencave të Komunës edhe zjarrfikësit për shkak se tash është koha e zjarreve të shikojmë për masat preventive që do të ndërmerren pas identifikimit të ndonjë rasti të zjarrit të cilët po paraqesin shkaktim të rrezikut të përgjithshëm.

Diqa tjetër nuk kam, nëse ka dikush nga anëtarët.

Nënkryetari i Komunës, atëherë e hapi diskutimin për këtë pikë, për raportin e komandantit sa i përket sigurisë së përgjithshme, nëse keni ndonjë kërkesë, sugjerim. Komandant, të kjo pjesa e tiketave, a keni mundur të diskutoni me prindërit?

Agim Idrizaj, të gjitha rastet ku hasim këta persona nën moshë, kontaktohen edhe prind, ka raste që e arsyeton fëmijën, por ka raste që thotë e ka marrë pa lejen time.

Nënkryetari i Komunës sepse është e rëndësishme me komuniku me prind, me qenë të informuar.

Agim Idrizaj, komunikimi është qelës i zgjidhjes së problemit, 80% të rasteve zgjidhen me komunikim edhe të shumë raste ndikon pozitivisht.

Nënkryetari i Komunës, faleminderit komandant. Kalojmë në pikën e radhës: **Diskutim mbi sigurinë në shkollë,** drejtor e ke fjalën.

Kastriot Duraku, fjala hyrëse. Realisht në bazë të raporteve të drejtorave të shkollave dhe të drejtorisë së arsimit, siguria në shkollë është në nivelin e duhur, përveç një incidenti, gjatë një kontrole në shkollën "Anton Cetta" stafi i shkollës ka hasur në një armë të ftohtë, një thikë pastaj gjatë kontrollës së vazhdueshme kemi hasur në një revole, gjë që drejtorja e shkollës e ka raportuar

rastin dhe e ka njoftu policinë me kohë, policia pastaj e ka sekuestru dhe ka ndërmarrë masat për rastin, ne nxënësin e kemi suspenduar dhe kemi marrë masat e nevojshme për të, tash është në dorën e policisë të vazhdoj me anën ligjore.

Kemi vazhduar me sesione dhe ligjërata infomuese dhe edukative ndaj nxënësve, tash jemi në përfudnim të vitit shkollor 2025-2026, gjatë kësaj jave e përfundojnë edhe klasat e nënta mësimin.

Na duhet bashkëpunim me policinë për problemin e telefonave në shkollë, ne i konfiskojmë telefonat sepse është rritur përdorimi i telefonave në shkollë mirëpo një udhëzim e përcakton që herën e parë i merret nga ana e shkollës, herën e dytë njoftohet prindi, herën e tretë telefoni dërgohet në polici, mirëpo siq jam informuar nga drejtorët e shkollave, policia nuk po i merr telefonat për arsye se po kanë shumë ankesa si: telefoni është i krisur, është i dëmtuar, dmth natyra të ndryshme të arsyeshmërisë.

Mirëpo e kishim bërë një zgjidhje sa i përket çështjes së telefonave. Kam qenë në një takim ne dy shkollat e mesme, sirtari i drejtorit kanë qenë diku mbi 30 telefona të cilët i ka marrë drejtori brenda një ditë, në qoftë se është e mundshme një lloj bashkëpunimi me policinë, një koordinim që të mund ta zvogelojmë këtë dukuri.

Ne tash në rregulloren e re e kemi futur si pikë, ku kemi disa masa pak me të mëdha sa i përket kësaj çështje, kështuqë bashk me komandantin me arrit një mirëkuptim në mënyrë që këtë dukuri ta zvogelojmë. Gjithashtu, është rritur përdorimi i cigareve elektronike, në oborre të shkollave dhe rreth tyre, jo në shkolla, ato po i blejnë të lokalet që janë afër, rreth, përballë shkollave.

Gjithashtu kërkojmë asistim, nga Policia, me 1 qershor e kemi ditën e fëmijevë, ku kemi një plan, një aktivitet gjithpërfshirës në qytet, diku 6 pika mbahet aktiviteti me fëmijë, fillon në shkollën "Shaban Jashari", sheshi, poligoni tek shtatorja e Leotrimt, tek çerdhja, në palestër dhe tek parku "Idriz Rrecaj. Kërkojmë nga policia asistencë dhe prezencë më të madhe pasi që janë 1200 fëmijë të involvuar në këtë aktivitet, sot do e dërgoj më shkresë kërkesën drejtuar Policisë për këtë aktivitet.

Agim Idrizaj, sa i përket çështjes së konfiskimit të telefonave ne zakonisht konfiskojmë gjëra të cilat duhet me evidentu në rast, për këto nuk hapet rast.

Valon Haliti, për problemin me cigare elektronike, kemi pasë aktivitet bashkë me policinë, është reduktuar pak por është prezente ende, duhet të vazhdojmë sistematikisht me këtë çështje edhe pse kemi edhe raste të gjobitjes.

Nënkryetari i Komunës, duhet të jenë të përfshirë të gjithë akterët, prind, policia, ne, mësuesit. Këto me i parapaj si çështje edhe ne rregullore që të jenë me strikte, masat disiplinore, në mënyrë që të bjen niveli i kësaj dukurie. Dikush tjetër, a ka me shtu diçka?

Avdi Jakupi, fjala hyrëse. Kemi telashe me sigurinë edhe pse nuk është që nuk kemi siguri, policia janë çdo ditë rreth shkollave, mirëpo nuk kemi preventiva të duhura, në shkolla takimet duhet të jenë më të shpeshta me prindër, orët e kujdestarive të jenë më të shpeshta, prindërit të thirren me shpesh në shkolla, jo

vetëm kur ndodhë problemi sepse atëhere është pak vonë. Tash meqenëse e kemi edhe draft-rregullorën, të njoftohen prindërit në fillim vit me disa rregulla pak me strikte, bashkëpunim më i madh me prindërit.

Nënkryetari i Komunës, sa i përket kësaj pike, me konstatimin e përbashkët kur rregullorja të hyjë në fuqi, në shtator me fillu me rregulla me strikte, diskutime më të shpeshta, me prindërit, kujdestaritë.

Nënkryetari i Komunës, pika e radhës, parandalim i dhunës në familje, zyrtarja për Barazinë Gjinore është në një takim, mund ta shtyjë për takimin e radhës, a jeni që pikën e 5 të rendit të ditës ta kalojmë për takimin e radhës. A jeni të gjithë për, kundër jo, abstenim jo, atëherë konstatoj që pika pesë parandalim i dhunës në familje hynë në rend të ditës për mbledhjen e ardhshme.

Kalojmë të **pika 6 siguria në komunikacion,** kaloj fjalën të komandanti, drejtori dhe pastaj e hap debatin për këtë pikë.

Agim Idrizaj, sa i përket sigurisë në trafik rrugor, përveç punëve preventive, janë ndërmarrë edhe masa ligjore, shqiptim i tiketave për kundërvajtje të ndryshme, janë lëshu 1103 tiketa gjatë kësaj periudhe pesë mujore, në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kalum janë kanë 1042. Të aksidentet në 2025 kemi pasur 19 aksidente me lëndime, 21 aksidente me dëmë materiale, ndërsa në këtë vit kemi 17 aksidente, dy me pak, mirëpo kemi rritje të aksidenteve me dëmë materiale, i kemi 28 raste. Situata nuk është keq por mund të jetë më mirë.

Mangësi kemi në zbatimin e kontrollimit të shpejtësisë, në mungesë të matësve të shpejtësisë, dhe sipas statistikës, shkaktari i aksidentëve është pikërisht shpejtësia.

Valon Haliti, në qytet ka sinjalizim të mjaftueshëm, ka mungesë në bashkësitë lokale të sinjalizimit vertikal, por megjithatë nuk është keq. Sa i përket statistikave të cilat i përmendi komandanti, mendoj që me tëpër janë për shkak të mospërshtatjes së shpejtësisë dhe kushteve të rrugës jo si rezultat i mungesës së sinjalistikës.

Pjesa e qytetit është e mbuluar mirë, si me sinjalizim vertikal ashtu edhe horizontal, në përjashtim të rrugëve ku pritet që të ndërhyjë Drejtoria e Urbanizmit me rregullimin e tyre.

Nënkryetari i Komunës, vazhdojmë në pikën 7. **Të ndryshme,** a ka dikush diçka?

Sokol Hoxha, fjala hyrëse, desha t'iu infrijoj juve dhe Kryetarin që jemi në një plan të organizimit të një ushtrimi fushor, që ka të bëjë edhe me sigurinë, prej emergjencave që i kemi pasur nga vërshimet Banka Botërore, Kryqi i Kuq dhe AME, ka zgjedhur Komunën e Skenderajt dhe Vushtrisë. Në bashkëpunim me ta 6 mujorin e fundit, jemi në dy donacione, e para nesër në shkollën Ahmet Delia, një donacion nga Banka Botërore, tjetra në shkollën në Tushilë dhe një për lumin brenda qytetit dhe urën.

Ne në bazë të Planit Operativ Lokal Emergjent, do të improvizojmë një gjendje lokale emergjente, duke krijuar një shtab emergjent, me datën 10 qershor, në shkollën Ahmet Delia ku do kemi evakuim dhe dhënien e ndihmës së parë. Ushtrimi do të bëhet vetëm në një lokacion, të shkolla, sepse ata e kanë parë gjendjen gjatë vërshimeve.

Nënkryetari i Komunës, atëherë suksese, jemi në kontakt dhe kontribuojmë të gjithë që ushtrimi të dalë sa më i mirë dhe i kompletum.

A ka dikush diqka tjetër të pika të ndryshme?

Nëse jo, iu falënderoj për pjesëmarrje, shihemi në takimin e radhës e punë të mbarë.

Procesmbajtës/e:

Besjana Thaçi

